

VENDIM
Nr. 27, datë 10.2.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GEGA-G”
SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pika 1 dhe 3, 4, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.2.2020, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “GEGA-G” sh.p.k., si dhe relacionin nr. 28/4 prot., datë 3.2.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “GEGA-G” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 124 prot., datë 22.1.2020, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat: “a”, “b”, “c”) është plotësuar pjesërisht;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d” “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar pjesërisht;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht;
- dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria “GEGA-G” sh.p.k., është regjistruar pranë QKB-së në datën 24.8.2001, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” me statusin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar dhe mban NUIS: K27713604T. Objekt i veprimtarisë së saj është: “Projektimi, ndërtimi dhe operimi i HEC-ve, ku përfshihet ndërtimi, vënia në punë, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike.

Në lidhje me mungesën apo plotësimin e dokumentacionit që ka të bëjë me:

formati dhe dokumentacioni për aplikim, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

Neni 9, pika 1:

- germa “c” (të dhëna për aplikuesin) do t’i kërkohet shoqërisë saktësimi i deklaratës në lidhje me ushtrimin e aktiviteteve të tjera.

Neni 9, pika 2: dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor,

- germa “d” (vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria) shoqëria duhet të përcjellë vërtetimet e Prokurorisë dhe Gjykatës për vetë shoqërinë.

Neni 9, pika 3: dokumentacioni financiar dhe fiskal,

- germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave) do t’i kërkohet shoqërisë të bëjë me dije mbi ecurinë e procesit të apelimit të gjobës;

- germa “b” (paraqitje e bilancit financiar të tri viteve të fundit) do t’i kërkohet të paraqesë në ERE edhe pasqyrat financiare për vitin 2018.

Neni 9, pika 4.8: dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

- germa “a” (sasia e energjisë elektrike të parashikuar për tu tregtuar në GWh sipas viteve), e paplotësuar;

- germa “b” (kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj), e paplotësuar;

- germa “c”(lista e kontratave të mëparshme të realizuara (nëse ka pasur)), e paplotësuar.

Për gjithë sa më sipër, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GEGA -G” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet në ERE rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti